



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
____.____.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 153, datë 14.04.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shumë mirë”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

EKSTRAKT

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARES {...}

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa aspekte.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “... *Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri të qarta për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes...*”.¹

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për të përcaktuar faktet e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit.

Gjyqtarja, në fillim të pjesës arsyetuese të vendimeve civile evidenton faktet e çështjes konkrete, të cilat në çdo rast rezultojnë të jenë pasqyruar në mënyrë koncize, të qartë, të kuptueshme dhe në mënyrë të përmbledhur.

¹ Në faqen 30 të Raportit.

Përcaktimi i fakteve të çështjes, në vendimet penale të analizuara (dosja 1 dhe 7) referuar natyrës së gjyqimit (gjykim penal), gjyqtarja pasi evidenton fillimisht elementët e ecurisë procedurale të çështjes (kërkesa për gjykim të shkurtuar), vijon me përshkrimin e faktit penal, sikurse ka rezultuar i provuar në gjykim nga tërësia e provave të administruara. Paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit është në çdo rast e detajuar, e qartë dhe e plotë, duke përshkruar ngjarjen gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, rolin e të pandehurit, veprimet që tregojnë bashkëpunimin midis të pandehurit me persona të paidentifikuar (dosja 1).

Në drejtim të identifikimit të natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, e cila orienton më pas ndërtimin e një strukture specifike në organizimin e arsytimit të vendimeve, në çështje me natyra të ndryshme (penale themeli, çështje familjare dhe çështje administrative). Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative apo penale.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet aftësia e gjyqtarës për të përcaktuar qartë dhe saktë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar në gjithë përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural dhe ligjit material, në vendin e duhur dhe në shërbim të analizës ligjore të çështjes.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në tre kategori (i) vendime civile (ii) vendime penale dhe (iii) vendime administrative, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*mosmarrëveshje për pasurinë e bashkësisë ligjore, depozitë bankare*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe dispozitave materiale të Kodit të Familjes.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit. Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenin 283/1 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Prodhimit dhe Shitjes së Narkotikëve”,² identifikon nenin 134/2 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Vjedhja” e kryer në bashkëpunim,³ nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”.⁴ Në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit, aplikimin e alternativave të dënimit apo dënimeve plotësuese (*nenet 47, 59 dhe 37 të K.Penal*).

² Vendimi nr. 64 (336) datë 11.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³ Vendimi nr. 64 (336) datë 11.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁴ Vendimi nr. 123 (606) datë 22.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

(ii) Në vendimet administrative, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here cituar në përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme, që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar, si pjesë e arsyetimit të vendimit, nenin 6 të K.Pr.Civile në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykimin civil (*vendimi nr. 1254, datë 17.11.2015, vendimi nr.351, datë 19.03.2015, vendimi nr. 637 datë 30.06.2016*); nenin 12 të K.Pr.Civile në lidhje me barrën e provës (*vendimi nr. 1254, datë 17.11.2015*); kompetencën lëndore të gjykatës administrative në raport me llojin e mosmarrëveshjes dhe shkakun ligjor të padisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 (*vendimi nr. 637, datë 30.06.2016*); nenin 309 të K.Pr.Civile, mbi dhënien e vendimit mbështetur vetëm në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore (*vendimi nr.351, datë 19.03.2015, vendimi nr. 637 datë 30.06.2016*), etj.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja identifikon dhe referon dispozitat e ligjit material, nenet 115-117 të K.Pr.Administrative dhe dispozitat e ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, “Për verifikimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, etj. (*vendimi nr.652, datë 04.07.2016*); nenin 153 të Kodit Civil dhe nenin 3 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, në lidhje me shpërblimin e drejtë të shpronësimit. Në këtë vendim identifikohet dhe zbatohet në vlerësimin e kërkimeve objekt padie edhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 01.12.2005, në lidhje me konceptin e së drejtës së pronësisë. (*vendimi nr. 350, datë 19.03.2015*); nenet 46 dhe 50 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, lidhur me procedurën e lëshimit të faturës tatimore, regjistrimin e tyre dhe njëkohësisht deklarinimin e shitjeve (*vendimi nr.1433, datë 27.10.2014*), etj.

Nga ana tjetër, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre, duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim, ka aftësi shumë të mira të identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Në përgjithësi, në vendimet gjyqësore të saj ajo shënon shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, siç janë: “titulli më i fortë”, “përplasia e titujve”, “parimi i sigurisë juridike” dhe “vendimeve të formës së prerë dhe të ekzekutueshme” (shih dosjen 3) si dhe “e drejta e pronës” dhe “e drejta e shpërblimit të drejtë” (shih dosjen 4). Pothuajse në të gjitha rastet, në funksion të interpretimit të ligjit, ajo ka përdorur edhe referenca në jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Tre dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile, penale dhe administrative, ku bien në sy regjimi i bashkëpronësisë midis bashkëshortëve (shih dokumentin 1), marrëdhëniet e punës (shih dokumentin 3 dhe dosjet 2 e 5), elementet e veprave të vjedhjes dhe shitjes së narkotikëve (shih dosjen 1), aktet administrative në fushën e tatimeve (shih dokumentin 2), vlera e kompensimeve për pasuritë e paluajtshme të shpronësuara (shih dosjen 4) dhe aktet për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (shih dosjen 3)...”⁵

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja identifikon, citon, dhe kur është rasti interpreton normën ligjore, duke e integruar me faktet e çështjes konkrete, në shërbim të analizës së fakteve dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj.

Në disa prej vendimeve përfundimtare, gjyqtarja interpreton normat e ligjeve të posaçme në raport me zbatimin e legjislacionit të posaçëm në raport me atë të përgjithshëm, siç është rasti i identifikimit të normave të Kodit të Punës në raport me normat e legjislacionit të posaçëm për statusin e nëpunësit civil (vendimi 829 datë 01.07.2015). Gjyqtarja ndalet në identifikimin dhe interpretimin e dispozitave të Kodit të Punës lidhur me standardet minimale të përcaktuara nga ky Kod për të drejtat e punëmarrësit, pavarësisht zbatimit të kuadrit ligjor të posaçëm në marrëdhëniet e punës (vendimi nr. 829, datë 01.07.2015, vendimi nr. 637, datë 30.06.2016).

⁵ Në faqen 31 të Raportit.

Evidentohet interpretimi i dispozitave të caktuara të ligjeve dhe akteve nënligjore, të tilla si: dispozita të ligjit nr. 49/2012, dispozita të posaçme të legjislacionit për regjistrimin e pasurisë (*vendimi nr. 1448 datë 28.12.2015*), dispozita të Kodit të Punës lidhur me marrëdhënien e punës, shkaqet e justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës (*vendimi nr. 1161, datë 27.10.2015, vendimi nr. 1254, datë 17.11.2015, vendimi nr. 1480 datë 31.10.2014*), dispozitat e Kodit të Familjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së martesës (*vendimi nr. 43, datë 28.01.2014*), dispozita të posaçme të legjislacionit tatimor (*vendimi nr. 1433, datë 27.10.2014*), dispozitat e Kodit Civil në lidhje me shkaqet e pavlefshmërisë relative të veprimit juridik (*vendimi nr. 267, datë 28.04.2014*), etj.

Në vendimet lidhur me marrëdhëniet e punës është karakteristik interpretimi i nenit 4 të Kodit të Punës, lidhur me fushën e zbatimit të këtij kodi, interpretimi i nenit 141 lidhur me mënyrën e përfundimit të marrëdhënieve të punës, interpretimi i neneve 143 dhe 144 të Kodit të Punës lidhur me afatin dhe procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke integruar interpretimin e dispozitave bashkë me rrethanat e faktit që kanë rezultuar të provuara, dhe duke konkluduar në lidhje me pasojën e zbatimit ose moszbatimit të dispozitave përkatëse, për çdo kërkim të objektit të padisë (*vendimi nr. 1161, datë 27.10.2015, vendimi nr. 1254, datë 17.11.2015, vendimi nr. 1480, datë 31.10.2014*).

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, duke referuar dhe interpretuar në disa raste edhe aspekte të veçanta të këtij parimi, të tilla si: parimi “*ratione personae*” (veprimi i ligjit ndaj personave),⁶ parimi i subsidiaritetit,⁷ parimi “*ratione materiae*” (ligji i zbatueshëm)⁸ dhe parimi “*ratio tempore*” (zbatimi në kohë).⁹

Evidentohet referimi dhe interpretimi i së drejtës së pronësisë parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e lidhur interpretimin e së drejtës së pronësisë, me shpërblimin e drejtë të vlerës së tregut për pronën e shpronësuar (*vendimi nr. 1448, datë 28.12.2015*).

Në vendimet e administruara evidentohet aftësia e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me konceptimin e së drejtës së pronësisë (*dosja 4 – referon vendimin nr. 30, datë 01.12.2005, të Gj. Kushtetuese*), në lidhje me individualizimin e dënimit (*dosja 7- referon konkluzionin e Vendimit nr. 19 datë 01.06.2011 të Gj. Kushtetuese*), lidhur me konstatimin e pavlefshmërisë së titullit të pronësisë (*dosja 10- referon konkluzionin e Vendimit nr. 29/2010 të Gj. Kushtetuese*).

Po kështu, në disa nga vendimet evidentohet referimi edhe analiza e jurisprudencës Unifikuese të Gjykatës së Lartë, lidhur me kuptimin e kërimit e palës paditëse për anulimin e aktit administrativ në mënyrë të njëkohshme me kërkimin e dëmshpërblimeve sipas Kodit të Punës (*vendimi 3, dosja 5 dhe 10 - ku gjyqtarja referon konkluzionin e Vendimit Unifikues nr. 19, datë*

⁶ Vendimi nr. 1161 datë 27.10.2015; Vendimi nr. 1480 datë 31.10.2014; Vendimi nr. 1254 datë 17.11.2015.

⁷ Vendimi nr. 1161 datë 27.10.2015.

⁸ Vendimi nr. 1480 datë 31.10.2014; Vendimi nr. 1161 datë 27.10.2015; Vendimi nr. 1254 datë 17.11.2015.

⁹ Vendimi nr. 68 datë 25.10.2019.

15.11.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Në vendimet penale, në aplikim të procedimit me gjykim të shkurtuar (dosja 1 dhe 8), gjyqtarja është referuar dhe ka analizuar, së bashku me bazën ligjore procedurale, edhe Vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2001, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, evidentohet përdorimi i Konventave Ndërkombëtare, si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, në shërbim të interpretimit të dispozitave materiale në lidhje me të drejtën e pronësisë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ((5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara nga gjyqtarja {...} përmbajnë strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Arsyetimin e vendimit e strukturon në paragrafë të evidentuar dhe sipas argumentit që merr në analizë. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe me referenca në ligj. Struktura e vendimit të saj është gjithmonë e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit

ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Ajo i kushton rëndësi arsytimit të vendimeve të ndërmjetëm, duke referuar edhe shkakun ligjor...”.¹⁰

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja në vendimet përfundimtare, gjatë gjykimit, si dhe në aktet procedurale të dosjeve të analizuara është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin e akteve.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është e pashmangshme përdorimi i saj. Në përdorimin e instituteve apo parimeve, gjyqtarja përdor shpesh termat latinë, por duke sqaruar kuptimin e tyre paraprakisht, si veprimi i ligjit ndaj personave– *ratione personae*; ligji i zbatueshëm– *ratione materiae*; zbatimi në kohë– *ratio tempore*.

Në shumicën e rasteve janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, me ndonjë përjashtim, ku vërehet mospërdorimi i shkronjës “ë”, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë vendimet tërësisht të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në këtë aspekt.

Gjyqtarja përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare për të shprehur mendimin, të cilat janë të qarta, të kuptueshme dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Gjithashtu paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit janë në vijimësi logjike të mendimit dhe nuk krijojnë shkopje të logjikës së arsytimit, brenda së njëjtës nënndarje të arsytimit të vendimit apo në gjithë vendimin në tërësi.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë, të arsytimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

¹⁰ Në faqet 20-21 të Raportit;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “....Struktura e vendimit të saj është gjithmonë e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Ajo i kushton rëndësi arsytimit të vendimeve të ndërmjetëm, duke referuar edhe shkakun ligjor...”.¹¹

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe në mënyrë të përmbledhur kërkimet përfundimtare të palëve.

Në pjesën përshkruese–arsyetuese gjejnë pasqyrim: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe dhe konkluzionin e arritur nga gjyqtarja.

Pjesa e dispozitivit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me cilësinë e vendimit, ekzekutimin e tij, të drejtën e ankimit, etj. Ndjekja e një strukture pothuajse të njëjtë në paraqitjen e vendimeve përfundimtare, e cila është karakteristike e qëndrueshme e gjyqtares, i bën vendimet e saj tepër të qarta dhe të kuptueshme.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta, në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

¹¹ Në faqen 31 të Raportit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara nga gjyqtarja {...} përmbajnë strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Arsyetimin e vendimit e strukturon në paragrafë të evidentuar dhe sipas argumentit që merr në analizë. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe me referenca në ligj. Struktura e vendimit të saj është gjithmonë e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Ajo i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetëm, duke referuar edhe shkakun ligjor...”.¹²

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në

¹² Në faqen 31 të Raportit;

lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në vendimet administrative evidentohet:

- Analizë dhe argumentim logjik i dispozitave që rregullojnë natyrën e marrëdhënies së punës dhe zgjidhjen e saj dhe pasojat ligjore që vijnë nga mosrespektimi i tyre. Në këto vendime gjyqtarja ka analizuar në mënyrë të veçantë çdo kërkim të objektit të padisë, duke referuar ose cituar dispozitat ligjore (neni 143,144,153 i K.Punës, etj.), ka analizuar kuptimin e tyre kur është vlerësuar e nevojshme, ndërthurjen me faktet e provuara në gjykim në raport me çdo kërkim, si dhe pasojën e parashikuar nga ligji, në rastet kur konkludohet për mosrespektim të dispozitës konkrete. Pjesë e analizës dhe argumentimit është edhe evidentimi i barrës së provës për punëdhënësin, për të provuar ligjshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, posaçërisht respektimin e procedurës dhe shkakun e justifikuar të zgjidhjes, si dhe pasojat që vijnë nga përmbushja ose mospërmbushja e barrës së provës në raport me këto aspekte.¹³ Gjithashtu, evidentohet në një rast argumentimi i konkluzionit të gjykatës për rrëzimin e kërimit për kthimin në punë, argumentim i cili vjen në lidhje logjike me argumentet e mëparshme për natyrën e mosmarrëveshjes, në referim të konkluzioneve të vendimit Unifikues nr. 31, datë 14.04.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.¹⁴

- Analizë lidhur me përcaktimin e llojit të marrëdhënies që është krijuar midis palëve në gjykim dhe ligjit të aplikueshëm për rregullimin e saj (neni 4 i K.Punës, dispozitat e ligjit nr. 152/2012, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar).¹⁵

- Analizë dhe argumentim logjik i konceptit të dëmshpërblimit, sipas përcaktimit në nenin 17 të ligjit 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me institutin juridik të shpërblimit për vjetërsinë në punë, sipas nenit 145 të K. Punës.¹⁶

- Analizë dhe argumentim ligjor, duke ndërthurur interpretimin e ligjit me rrethanat e faktit dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, në raport me legjislacionin tatimor. Në këtë rast gjyqtarja ka marrë në analizë procedurën e lëshimit të faturës tatimore, regjistrimin e tyre në librin e shitjes dhe deklarin në Formularin e Deklarimit të Pagesës së TVSH (nenet 46, 50 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”; nenet 36, 37 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për TVSH-në), situatën e faktit lidhur me konstatimin e shkeljes nga ana e paditësit, identifikimin e shkeljeve të konstatuara në referim të nenit 37 të ligjit nr. 9920/2008.¹⁷

- Analizë lidhur me kompetencat e organit administrativ për konstatuar pavlefshmërinë e aktit administrativ në ushtrimin e kompetencave të tij si organi

¹³ Vendimi nr. 1254 datë 17.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Vendimi nr. 1161 datë 27.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; Vendimi nr. 1480 datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

¹⁴ Vendimi nr. 1161 datë 27.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

¹⁵ Vendimi nr. 637 datë 30.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

¹⁶ Vendimi nr. 829 datë 01.07.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

¹⁷ Vendimi nr. 1433 datë 27.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

administrativ e pror, analizë e cila vjen në shërbim të konkluzionit të arritur nga gjyqtarja, që pavarësisht kompetencës së organit administrativ për të konstatuar pavlefshmërinë e aktit administrativ, duke qenë se për shkak të këtij akti kanë lindur të drejta pronësie, atëherë legjislatori ka parashikuar që vetëm një organi i pavarur, duhet të konstatojë pavlefshmërinë e këtij titulli.¹⁸

- Analizë lidhur me legjitimitetin aktiv të palës paditëse në ngritjen e padisë për kërkimin e shpronësimit të pronës së paditësit në funksion të një qëllimi publik, analizë e cila pasurohet duke referuar, veç parashikimeve të ligjit dhe nenit 41 të Kushtetutës, edhe në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 30, datë 01.12.2005. Në funksion të analizës gjyqtarja analizon parimet kushtetuese të të drejtës së pronës dhe shpërblimit të drejtë, si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut.¹⁹

Në vendimin civil evidentohet:

- Referuar kërkimit të palës paditëse për anulimin e kontratës së depozitës dhe detyrimin e lidhjes së kontratës së depozitës vetëm midis palës paditëse dhe bankës, si pasuri vetjake, gjyqtarja ndalet në analizimin e kushteve të vlefshmërisë së kontratës dhe në mbështetje edhe të normave konkrete (nenit 1024 në lidhje me nenin 660 dhe 94 të K.Civil) konkludon se nuk gjeti të provuar asnjë prej rasteve të pavlefshmërisë relative. Po kështu, në funksion të argumentimit të konkluzionit të gjykatës për rrëzimin e kërkimit për vërtetimin gjyqësisht se depozita është pasuri me karakter vetjak, gjyqtarja analizon normën ligjore në lidhje me pasurinë e fituar gjatë martesës (nenin 77/b në lidhje me nenin 311/2 të K.Familjes).²⁰

Në vendimet penale evidentohet:

- Gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë analizimit të katër elementëve të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, duke u ndalur në mënyrë më specifike tek ana objektive e veprës penale. Gjyqtarja identifikon lidhjen shkak-pasojë, të veprimeve të të pandehurit në ardhjen e pasojës së dëmshme, gjatë analizës së veprës penale që i atribuohet të pandehurit. Interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërbejnë arsytimit për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprës penale për të cilat procedohet, ecurinë procedurale të gjykimit, kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

¹⁸ Vendimi nr. 652 datë 04.07.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

¹⁹ Vendimi nr. 350 datë 19.03.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

²⁰ Vendimi nr. 267 (673) datë 28.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Aftësia organizative e gjyqtarës pikëzohet duke vlerësuar aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në interpretim të pikës 3 shkronja “c”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregullim nënkupton një ngarkesë prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Nga të dhënat*

statistikore të gjyqtarës Koldiana{...} konstatohet lehtësisht se ajo ka patur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal... Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 3 raste është respektuar afati ligjor (shih dosjen 1), apo afati standard i gjykimit (shih dosjet 2 dhe 5). ...Shkak për tejkalimin e afateve në këto çështje është bërë mosnjohimi i palëve, planifikimi i seancave dhe mosorganizimi i punës. Megjithatë, në analizën e kësaj të dhëne duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa tepër e lartë sasiore e gjyqtarës...”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe 1 çështje të administruar për shkak të ankesave.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu edhe për çështjet civile në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit, ose të kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si: kërkesa për sigurimin e padisë, për të cilën neni 28 pika 3, i Ligjit nr. 49/2012, parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit, apo çështje të tjera administrative, të cilat sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe 1 çështje të administruar për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për asnjë prej tyre nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat nuk parashikohet ndonjë afat ligjor për përfundimin e tyre aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe 1 dosjeje të administruar për shkak të ankesave.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“...Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë në intervale kohore nga 2 muaj e 13 ditë (shih dosjen 1) deri në 10 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3). Çështja që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 10 muaj e 26 ditë, ka qenë mosmarrëveshje në fushën e regjistrimit të pronave të paluajtshme, në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli, ku shkak për tejkalimin e afatit është edhe mosorganizimi i mirë i punës nga ana e gjyqtares, e cila ka vendosur të parashtrojë mosmarreveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e kërtimeve të çështjes pas afro dy muajve nga shortimi i çështjes. Gjithashtu, në tejkalimin e afatit ka ndikuar edhe dështimi i seancës së 5 përgatitore, për mosparaqitje të palëve ndërgjyqëse, në të cilën mungojnë në dosje aktet e njoftimit për palët. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 3 muaj e 7 ditë (shih dosjen 5), 3 muaj e 15 ditë (shih dosjen 2), dhe 6 muaj e 18 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në 3 raste është respektuar afati ligjor (shih dosjen 1) apo afati standard i gjykimit (shih dosjet 2 dhe 5). Ndërsa në 2 raste është tejkaluar afati standard i gjykimit prej 1 muaji (shih dosjet 3 dhe 4). Shkak për tejkalimin e afateve në këto çështje është bërë mosnjoftimi i palëve, planifikimi i seancave dhe mosorganizimi i punës. Megjithatë, në analizën e kësaj të dhëne duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa tepër e lartë sasiore e gjyqtares...”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht tej standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezulton se:

Çështje penale:

- Dosja 1 – (është caktuar me short në datën 26.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 11.03.2014). Gjykimi ka zgjatur 75 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 8– (është caktuar me short në datën 20.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 22.04.2014). Gjykimi ka zgjatur 61 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Çështje familjare:

- Dosja 7 -(është caktuar me short në datën 05.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 28.01.2014). Gjykimi ka zgjatur 54 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet familjare.

Çështje administrative:

- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 16.03.2015 dhe ka përfunduar në datën 01.07.2015). Gjykimi ka zgjatur 107 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 02.02.2015 dhe ka përfunduar në datën 28.12.2015). Gjykimi ka zgjatur 329 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 4 - (është caktuar me short në datën 01.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 19.03.2015). Gjykimi ka zgjatur 199 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 5 - (është caktuar me short në datën 20.07.2015 dhe ka përfunduar në datën 27.10.2015). Gjykimi ka zgjatur 99 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 04.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 19.03.2015). Gjykimi ka zgjatur 105 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 25.03.2015 dhe ka përfunduar në datën 24.07.2015). Gjykimi ka zgjatur 121 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 10 -(është caktuar me short në datën 01.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 31.10.2014). Gjykimi ka zgjatur 60 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 11 -(është caktuar me short në datën 23.11.2015 dhe ka përfunduar në datën 04.07.2016). Gjykimi ka zgjatur 227 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Dosja 12 -(është caktuar me short në datën 18.02.2016 dhe ka përfunduar në datën 30.06.2016). Gjykimi ka zgjatur 132 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor.

Vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja:

- Vendimi 1 -(është regjistruar në datën 24.10.2013 dhe ka përfunduar në datën 28.04.2016). Gjykimi ka zgjatur 186 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet civile të përgjithshme;
- Vendimi 2 -(është caktuar me short në datën 01.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 27.10.2014). Gjykimi ka zgjatur 56 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor;
- Vendimi 3 -(është regjistruar në datën 09.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 17.11.2015). Gjykimi ka zgjatur 69 ditë, tej standardit minimal kohor 30 ditor.

Konstatohet se vendimet janë marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, vetëm në kategorinë e çështjeve administrative, ndërsa për kategorinë e çështjeve penale, civile si dhe familjare, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor.

Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në raport me numrin e çështjeve të analizuar (11/15) rezulton së çështjet e shqyrtuara në tejkallim të standardit minimal kohor, përbëjnë mbi 73 % të tyre.

Pavarësisht kalimit të standardit kohor 30 ditor të parashikuar në kriteret matëse për çështjet administrative, sipas vendimit nr. 261/2 të KLD, vlerësohet se kohëzgjatja e gjykimit në çdo çështje të vëzhguar ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe nuk përbën kohëzgjatje të paarsyeshme. Në vlerësimin e këtij treguesi mbahet parasysh afati që standardi minimal kohor 30 ditor për gjykimet administrative është përcaktuar në vitin 2010, ndërkohë që legjislacioni i posaçëm për gjykimet administrative është miratuar dy vite më vonë, duke parashikuar afate për kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e gjykatës, respektimi i të cilave me rigozitet, e bën të vështirë respektimin e standardit minimal kohor në fuqi për kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve administrative. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji rezulton të jenë zbatuar me rigozitet nga gjyqtarja në të gjitha çështjet e vëzhguara, pavarësisht faktit se standardi minimal kohor në fuqi nuk është zbatuar në dukje, në 9 dosjet e përzgjedhura me short dhe 2 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

Në tërësi, duke iu referuar 9 çështjeve administrative të përzgjedhura me short dhe 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit rezulton të jetë rreth 137 ditë.²¹ Duke krahasuar mesataren e kohëzgjatjes së çështjeve të vëzhguara, përllogaritur si më sipër, me afatin që rezulton nga mbledhja e afateve ligjore, përllogaritur në treguesin më sipër i cili rezulton 87 ditë, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është me e gjatë se standardi minimal kohor në fuqi, si dhe është dukshëm më e gjatë se afati i përllogaritur si më sipër.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 70 %, si dhe shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sipas burimeve të vlerësimit, shkaqe të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, por për shkaqe objektive që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, njoftimin e tyre etj., ky tregues pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “0-10 %”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

²¹ Kohëzgjatja mesatare e gjykimit, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e gjykimit për tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari është e përafërt pasi për këto 3 burime nuk ka të dhëna për datën e shortimit apo mundësinë e rishortimit të çështjeve (për shkak të ndryshimit të trupit gjykues ose shkaqe të tjera) por vetëm për datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe 1 çështjeje të administruar për shkak të ankesave, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.²²

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (15 çështjet e marra në analizë 11 janë çështje administrative, 2 janë çështje penale themeli, 1 çështje civile themeli dhe 1 çështje familjare), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë 68 ditë ose 2 muaj e 8 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.²³
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “familjare”, rezulton të jetë 54 ditë ose 1 muaj e 24 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muajsh për gjykimin e çështjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “civile themeli”, rezulton të jetë 186 ditë rreth 6 muaj e 3 ditë, pra e barabartë me standardin minimal kohor prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.

²² Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

²³ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se :” Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

(iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “administrative”, rezulton të jetë rreth 137 ditë ose 4 muaj dhe 15 ditë, pra më i gjatë se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, si dhe nga provat e paraqitura nga gjyqtarja, rezulton se gjatë vitit 2014 dhe 2016, ka pasur një rritje të papritur të volumit të çështjeve, dhe konkretisht gjyqtarës i janë caktuar brenda një dite 126 çështje dhe 50 çështje, ndërkohë që shorti vazhdonte të vijonte normalisht çdo ditë, duke sjellë ngarkesën e vazhdueshme të çështje të reja. Po kështu, duke e lidhur këtë edhe me kushtet e punës, kushte të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e gjyqtarës, duke e bërë të pamundur ushtrimin me efikasitet të plotë të funksionit të gjyqarit dhe respektimin e afateve të arsyeshme, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se “...Subjekti rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë (gjer më 28.07.2014) dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ajo ka deklaruar se tre vitet e fundit të detyrës i janë caktuar për gjykim gjithsej 1907 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar si kryesuese gjithsej 1580 çështje gjyqësore, duke mbartur vitin e fundit 364 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 82,8%...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në total, gjatë gjithë periudhës së vlerësimit, gjyqtarës {...}: në vitin 2014 (01.01.2014 – 28.07.2014) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë i janë caktuar 111 çështje dhe ka përfunduar 163 çështje. Po këtë vit (01.09.2014-31.12.2014), në Gjykatën Administrative

të Shkallës së Parë Durrës i janë caktuar 319 çështje dhe ka përfunduar 184 çështje. Përfundimisht, përgjatë vitit 2014 gjyqtares {...} i janë caktuar gjithsej 430 çështje dhe ka përfunduar 347 çështje. Në vitin 2015 i janë caktuar 539 çështje dhe ka përfunduar 530 çështje. Në vitin 2016 i janë caktuar 938 çështje dhe ka përfunduar 703 çështje. Në vitin 2016 ka mbartur 364 çështje për vitin 2017. (*sipas Raportit të analizimit të aftësive profesionale, faqe 3*). Ndërkohë, rezulton se ka përfunduar në gjithë periudhën e vlerësimit, sipas tabelave me të dhëna statistikore të administruara në faqen 103 deri 127 të dosjes së rivlerësimit, 1448 çështje, nga të cilat 608 çështje administrative, 141 marrëdhënie pune, 115 civile të përgjithshme, 71 penale themeli, 53 çështje familjare, 434 urdhra ekzekutimit dhe 26 kërkesa civile.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 82,8 % i përcaktuar në faqen 32 të Raportit, faqe 1166 e dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 82,8%, të dhënave statistikore të dorëzuara nga gjyqtarja, nga ku rezulton se periudhën e vlerësimit ka pasur një rritje të menjëhershme në volumin e çështjeve, rritje kjo e cila sjellë ndikimin e vetë në llogaritjen matematikore të rendimentit, si dhe volumin e madhe të ngarkesës së punë, por kështu duke pasur parasysh edhe Metodologjinë e Pikëzimit, ku përcaktohet se “*gjyqtari që ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës për përcaktuara*”, ku për gjyqtaren {...} rezulton se standardi sasior i punës është dukshëm më e madhe se 50 %, (*gjyqtari i shkallës së parë, seksioni administrative jo më pak se 150 gjykime, ndërkohë që gjyqtarja për vitin 2015 ka përfunduar 382 çështje më palë kundërshtare, pa përfshirë këtu kërkesat civile; për vitin 2016 ka përfunduar 242 çështje me palë kundërshtare pa përfshire këtu kërkesat civile*) aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, është “Mbi 87-93 %”, duke e pikëzuar me 6 pikë.*

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të

administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, si dhe 1 çështje të administruar për shkak të ankesave.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykatat²⁴ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar;
- Të dhëna nga burimet arkivore të KLD/KLGJ.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“...Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, me tejkalime tepër të vogla, 1 deri 2 ditë nga afati ligjor. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 8 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe pas 9 ditëve nga shpallja (shih dosjet 2, 3 dhe 5). Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së 2 ankesa, 1 ankesë e vitit 2015 e verifikuar për vonesë në zbardhjen e vendimit, është sugjeruar tërheqje e vëmendjes me shkrim gjyqtares, ndërsa ankesa tjetër e vitit 2016 e verifikuar për 2 ditë vonesë në zbardhjen e vendimit, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së)...”*²⁵

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

²⁴ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nëpërmjet shkresës nr. 321 Prot., datë 12.10.2020 dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës nëpërmjet shkresës nr. 184 datë 12.10.2020.

²⁵ Në faqen 32-33 të tij.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 64, datë 11.03.2014, është dorëzuar në datën 17.03.2015 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 814, datë 01.07.2015, është dorëzuar në datën 10.07.2015 - (9 ditë); tej afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 1448, datë 28.12.2015, është dorëzuar në datën 06.01.2016 - (9 ditë); tej afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 350, datë 19.03.2015, është dorëzuar në datën 27.03.2015 - (8 ditë); tej afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 1161, datë 27.10.2015, është dorëzuar në datën 06.11.2015 - (9 ditë); tej afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 6,²⁶ që i përket vendimit me nr. 814, datë 01.07.2015, është dorëzuar në datën 10.07.2015 - (9 ditë); tej afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nëpërmjet shkresës nr. 321 Prot., datë 12.10.2020 dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës nëpërmjet shkresës nr.184 datë 12.10.2020, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 10.09.2020, rezulton se:

- Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 43 (104), datë 28.01.2014, është dorëzuar në datën 06.02.2014 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 123 (606) datë 22.04.2014, është dorëzuar në datën 28.04.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr. (822015-554) 949, datë 24.07.2015, është dorëzuar në datën 29.07.2015- (5 ditë); brenda afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3, të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 1480, datë 31.10.2014, është dorëzuar në datën 06.11.2014- (4 ditë); brenda afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3, të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 652, datë 04.07.2016, është dorëzuar në datën 11.07.2016- (7 ditë); brenda afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3, të Ligjit nr.49/2012.
- Dosja 12, që i përket vendimit me nr. (82-2016-970) 637, datë 30.06.2016, është dorëzuar në datën 06.07.2016- (6 ditë); brenda afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 42 pika 3, të Ligjit nr.49/2012.

²⁶ Analizuar ne Raportin shtesë nr. 2776/5 Prot., datë 11.06.2019, administruar në dosjen e rivlerësimit

Në relacionin e datës 12.02.2016, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit nr. 126, datë 03.02.2015 nga gjyqtarja {...}, ku ka rezultuar se dosja që i përket vendimit nr. 126, datë 03.02.2015, është dorëzuar në sekretarinë e asaj gjykate në datën 25.09.2015, pra pas 7 (shtatë) muajsh e 22 ditësh nga shpallja. Afati ligjor për dorëzimin e dosjes gjyqësore pas dhënies së vendimit përfundimtar nga gjyqtari është 7 ditë.

Po kështu, në relacionin e datës 24.05.2016, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit nr. 1087, datë 12.10.2015 nga Gjyqtarja {...}, ku ka rezultuar se dosja që i përket vendimit nr.1087, datë 12.10.2015, është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 21.10.2015, pra pas 9 (nëntë) ditësh nga shpallja.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë penale krime, për 2 dosje është 6 ditë. Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë civile themeli, për 1 dosje është 9 ditë. Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë administrative, për 9 dosje si dhe dy dosje të trajtuara në relacionet e Inspektoratit të KLD është 27.3 ditë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja, ka paraqitur kundërshtime duke parashtruar se: “Në lidhje me vendimin nr. 126, datë 03.02.2015, afati i dorëzimit të të cilit është bërë objekt inspektimi, dhe në lidhje me këtë afat përllogaritet 7 muaj e 22 ditë nga shpallja, moment që lidhet me dorëzimin e dosjes në sekretarinë gjyqësore, nuk më është bërë e ditur apo e njohur relacioni i përgatitur në lidhje me këtë inspektim të kryer, për rrjedhojë as fakti se ndaj meje është propozuar tërheqje vëmendje, “ndëshkim administrativ”, jo i parashikuar në ligj, lidhur me gjetje që përben shkelje disiplinore nga gjyqtari referuar legjislacionit të kohës. Vendimi është shpallur në datë 03.02.2015, në mungesë të palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës. Në lidhje me këtë vendim është ushtruar ankim në datën 17.02.2015 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Nga ana e kryetarit të kësaj gjykate është marrë vendim për pranimin e ankimit të bërë nga DRT Durrës kundër këtij vendimi. Nga këto akte rezulton qartazi se vendimi i arsyetuar i është komunikuar përfaqësuesit të palës së paditur dhe është ushtruar ankim ndaj këtij vendimi në datën 17.02.2015, pra vendimi maksimalisht është arsyetuar në datën 17.02.2015 kur është marrë në shqyrtim dhe ankimi i bërë kundër tij dhe është disponuar me vendim për pranim ankimi nga Kryetari i Gjykatës”.

Lidhur me këto shpjegime gjyqtarja ka paraqitur kopje të ankimit të nr. 24870/2 Prot., datë 17.02.2015, me ankues Drejtorin Rajonale Tatimore Durrës, si dhe vendimin e pranimin të ankimit datë 17.02.2015. Në përmbajtje të ankimit të paraqitur si provë nga gjyqtarja, rezulton se pala ankuese në faqen 2 të tij shprehet se “Ju bëjmë me dije se nuk jemi njohur me vendimin e gjykatës dhe rezervojmë të drejtën për të dhënë argumente shtesë në lidhje me qëndrimin që do të mbajmë për këtë çështje”.

Po kështu, referuar përmbajtjes së relacionit datë 12.02.2016, mbi verifikimin e ankesës të ardhur nga shtetasi T.L, në të cilin gjyqtarja ka dhënë edhe shpjegime, rezulton se “U

provua se dosja që i përket vendimit nr. 126, datë 03.02.2015, i dhënë nga gjyqtare {...}, u dorëzua në sekretarinë e asaj gjykate më datë 25.09.2015, pra pas 7 (shtatë) muajsh e 22 ditësh nga shpallja.

Edhe po të rillogaritet koha e arsytimit të vendimit përfundimtar, për çështjet të cilat vendimi është dorëzuar nën 10 ditë, duke llogaritur ato vetëm me ditë pune, koha mesatare për 9 dosjet e përzgjedhura me short, si dhe dy dosje të trajtuara në relacionet e Inspektoratit të KLD është 22.76 ditë. Pra edhe me këtë rillogaritje, koha mesatare e arsytimit të vendimit për kategorinë *administrative*, është dukshëm më e gjatë se afati 7 ditor i përcaktuar në nenin 42 pika 3, të Ligjit nr.49/2012.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, gjyqtarja pikëzohet me 12 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 4 seanca (shih dosjen 5), me 6 seanca (shih dosjen 1), me 10 seanca (shih dosjen 2), me 11 seanca (shih dosjen 3) dhe me 14 seanca (shih dosjen 4). Këto të

dhëna tregojnë se janë vëzhguar 45 seanca gjyqësore, nga të cilat 29 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 16 seanca gjyqësore joproduktive është bërë mosformimi i trupit gjykues, kryesisht për shkaqe shëndetësore të gjyqtarës (7 seanca), mosparaqitja e ekspertëve (4 seanca), kërkesat e palëve për shtyrje (3 seanca) dhe mosparaqitja e palëve (2 seanca). Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre. Janë evidentuar vetëm dy vonesa 15 e 20 minuta, por në një të prej tyre është relatuar dhe pasqyruar shkaku objektiv i vonesës (shih dosjen 1), ndërsa në rastin tjetër nuk është relatuar (shih dosjen 3)...”²⁷

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, si dhe 1 çështje të administruar për shkak të ankesave, lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, evidentohet:

- ❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Janë vëzhguar gjithsej 45 seanca, nga të cilat 29 seanca produktive dhe 16 seanca joproduktive. Këto seanca janë shtyrë: (i) në 7 raste, për mosformim të trupit gjykues, kryesisht për shkaqe shëndetësore; (ii) në 4 raste, për shkak të mosparaqitjes së ekspertit; (iii) në 3 raste, për shkak të kërkesave të palëve (iv) në 2 raste, për shkak të mosparaqitjes së palëve.

- ❖ Në çështjen e administruar në dosjen e rivlerësimit për shkak të ankesave konstatohet se:²⁸

Janë caktuar gjithsej 7 seanca, nga të cilat 5 seanca gjyqësore, me distancë 15 ditë nga njëra tjetra. Ndër 7 seanca të zhvilluara, vetëm në një rast është konstatuar mosnjoftimi i palës së paditur, dhe pikërisht për shkak të këtij mos njoftimi, është vendosur shtyrja e seancës gjyqësore dhe njoftimi i palës.

- ❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Në çështjen civile (dosja 7), me nr. 155/1120 (1415) regjistri, datë regjistrimi 05.12.2013, me objekt zgjidhje martesë, përfunduar me vendimin nr. 43 (104), datë 28.01.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar një seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, përse kohë ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar. Seanca ka filluar në kohë dhe është dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore, të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

²⁷ Në faqen 33 të raportit.

²⁸ Analizuar në raportin shtesë për 5 dosje gjyqësore të subjektit të rivlerësimit Klodiana Viezi për procesin e rivlerësimit kalimtar, me nr. 2776/5 Prot., datë 11.06.2019, në faqen 3 të tij.

Në çështjen penale (dosja 8), me nr. 122 (101) regjistri, datë regjistrimi 18.02.2014, ndaj të pandehurit Armand Godini akuzuar për veprën penale “Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 123 (606), datë 22.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar katër seanca gjyqësore, dy prej të cilave kanë qenë joproduktive. Shtyrja e seancës ka ndodhur për shkaqe procedurale, për t’i mundësuar mbrojtësit të caktuar të njihej me aktet e dosjes, me qëllim realizimin e një mbrojtjeje efektive, si dhe për t’i lënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim. Seancat kanë filluar në kohë dhe vetëm një prej tyre është regjistruar me sistemin FTR audio.

Në katër çështjet administrative: (i) dosja 9, me nr. (00326) 917, datë regjistrimi 23.03.2015, me objekt shfuqizim akti, përfunduar me vendimin nr. (82-2015-554) 949, datë 24.07.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; (ii) dosja 10, me nr. 1658, datë regjistrimi 31.07.2014, me objekt padi marrëdhënie pune, përfunduar me vendimin nr. 1480, datë 31.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; (iii) dosja 11, me nr. 31025-01524-82-2015 (1772), datë regjistrimi 19.11.2015, me objekt shfuqizim akti, përfunduar me vendimin nr. 652 (82-2016-998), datë 04.07.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës; (iv) dosja 12, me nr. 31025-00266-82-2016 (641), datë regjistrimi 15.02.2016, me objekt padi marrëdhënie pune, përfunduar me vendimin nr. 637 (82-2016-970), datë 30.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Në këto çështje janë zhvilluar gjithsej 11 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore, të mbajtur nga sekretarja gjyqësore. Rezulton se 6 seanca gjyqësore kanë qenë joproduktive, dhe shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore në këto katër çështje kanë qenë për arsye procedurale, konkretisht:

- një rast - njoftimi i personit të tretë pasi nuk konfirmohej marrja dijani (*dosja 9*);
- dy raste - lënien kohë palëve për të përgatitur pretendimet përfundimtare (*dosja 9, 10*);
- tre raste - për shpalljen e vendimit të arsyetuar (*dosja 9, 10, 11*);
- një rast – mosformim i trupit gjykues, për arsye shëndetësore (*dosja 9*).

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 12 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtarë (penale themeli, civile themeli dhe administrative) varion nga 1 deri në 8 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3.8 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, (*çështje civile, penale themeli dhe administrative*), si dhe 1 dosjeje të administruar për shkak të ankesave, rezulton se gjyqtarja ka kryer në përgjithësi, me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar përgjithësisht ligjin procedural penal dhe atë civil (nenet 333/1 e 342/2 të K.Pr.Penale, nenet 302 e 308/2 të K.Pr.Civile, si dhe nenet 25 e 27 të ligjit 49/2012).

Ligji procedural është respektuar ‘në përgjithësi’, pasi në disa raste është konstatuar se gjyqtarja ka kryer veprimet përgatitore të çështjes tej afatit ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 25 të ligjit 49/2012 (*dosja 11, 12*); caktimin e seancës gjyqësore tej afati ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 të ligjit 49/2012 (*dosja 9, 11, 12*); caktimin e seancës për pretendime përfundimtare, tej afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 302 të K.Pr.Civile (*dosja 9*).

Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke pasur parasysh se gjykimet janë zhvilluar në kushtet e një ngarkese teje të lartë, kushteve të punës, si dhe faktit se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet në nivelin “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se “...*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej*

saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në 4 çështje administrative themeli të vëzhguara, ajo ka kryer veprimet përgatitore, të cilat janë dokumentuar rregullisht me procesverbal dhe efektiviteti i tyre ka qenë në nivelin e duhur....Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet gjyqësore administrative brenda afatit 7 ditor të parashikuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012, por në vijim nuk merr masat për kryerjen e veprimeve të duhura në afate të shkurtra. Po kështu, gjyqtarja ka vendosur dhe ka shqyrtuar kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr. 49/2012. Por, në dosjen 3, gjyqtarja ka vendosur të parashtrijë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e kërkimeve të çështjes pas afro dy muajve nga shortimi i çështjes. Distanca kohore midis seancave janë nga 15 ditë deri në 1 muaj nga njëra-tjetra. Ajo e ka respektuar afatin 5 ditor të shtyrjes së seancës për diskutimin përfundimtar apo për shpalljen të arsyetuar të vendimit... ”²⁹.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 1 çështje të administruar për shkak të ankesave, të gjitha i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare.

Në 2 (dy) çështje penale të vëzhguara, rezulton se gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale, si dhe janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal, sipas parashikimeve të nenit 405 e vijues, të procedimit me gjykim të shkurtuar.

Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për të relatuar verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në 9 (nëntë) çështjet administrative të vëzhguara, përgjithësisht rezulton se gjyqtarja i kryen veprimet përgatitore, sipas parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, duke i zhvilluar ato brenda harkut kohor nga 3 deri në 7 ditë nga momenti i shortimit. Në dy raste janë konstatuar se këto veprime janë kryer tej afatit ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 25 të ligjit 49/2012, konkretisht pas 15 dhe 29 ditësh.

²⁹ Në faqen 33 të tij.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1, të Ligjit nr.49/2012, duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afati ligjor 10 ditor, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b”, të Ligjit nr. 49/2012.

Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim të provave, gjyqtarja ka zhvilluar veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal veprimet e kryera për verifikimin e njoftimeve drejtuar palës së paditur, datën e komunikimit të tyre, paraqitjen ose jo të prapësimeve me shkrim nga pala e paditur brenda afatit të caktuar nga gjykata, caktimin e një afati të ri për paraqitjen e prapësimeve dhe provave për të paditurin sipas parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, liston provat shkresore të paraqitura nga palët, si dhe disponon për caktimin e seancës përgatitore duke evidentuar shkaku për caktimin e seancës përgatitore.

Në dosjet e vëzhguara, në çdo rast është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore me qëllim përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe zgjidhjen e çështjes në mënyrë të drejtë.

Pas zhvillimit të veprimeve përgatitore, gjyqtarja ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përgjithësisht brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1, të ligjit nr. 49/2012. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27 pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 3, të ligjit nr.39/2012. Në tre raste konstatohet se gjyqtarja ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, tej afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 të ligjit 49/2012, respektivisht 21 ditë, 23 ditë, 16 ditë (*dosja 9, 11, 12*).

Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përlligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat dhe mbi elementët proceduralë të zhvillimit të gjykimit; dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare, duke i dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.Civile; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar, ose shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të

arsyetuar brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42 pika 2, të ligjit nr. 49/2012 (*dosja 9, 10 dhe 11*).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur në orarin e caktuar. Veprimet përgatitore dhe seancat përgatitore janë dokumentuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore, vetëm në një rast seanca gjyqësore është dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar përgjithësisht afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 16 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, konkludohet se “...Dokumentacioni në 5 dosjet e vëzhguara në përgjithësi është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti në shumicën e tyre janë të sakta nga ana formale. Procesverbalet që dokumentojnë veprimet përgatitore apo seancat gjyqësore përgjithësisht janë të plota, duke dokumentuar palët pjesëmarrëse dhe veprimet e kryera, sipas kërkesave të ligjit procedural. Radhitja dhe sistemimi i akteve në dosje ndjek të njëjtën metodologji dhe kronologji, pasi administrohen më parë aktet e paraqitura nga

palët e më pas ato të krijuara nga gjykata, duke e bërë të lehtë shfrytëzimin e dosjeve për palët. Në shumicën e rasteve, aktet në dosje janë të inventarizuara shumë shkurt... ”³⁰.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit), brenda së njëjtës kategori.

Renditja e dosjes civile fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, procesverbalin e shortit, padinë dhe provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (kur prapësimet janë paraqitur me shkrim), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit, procesverbalet e seancave të veprimeve paraprake, të seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të zbardhura, vendimi gjyqësor përfundimtar, vendimi për pranimin e ankimit në rastet kur palët kanë paraqitur ankim, aktet e njoftimit të vendimit dhe procesverbali me shkrim ose audio i seancave gjyqësore.

Renditja e akteve në dosje dosjet penale është e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, (mungon vendimi i gjyqtarës për caktimin e seancës gjyqësore), njoftimet e palëve, deklaratimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilat janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimin të kërkesës për gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave, si dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 5 pikë.*

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

³⁰ Në faqen 33 të raportit.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Dokumentacioni në 5 dosjet e vëzhguara në përgjithësi është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti në shumicën e tyre janë të sakta nga ana formale. Procesverbalet që dokumentojnë veprimet përgatitore apo seancat gjyqësore përgjithësisht janë të plota, duke dokumentuar palët pjesëmarrëse dhe veprimet e kryera, sipas kërkesave të ligjit procedural. Radhitja dhe sistemimi i akteve në dosje ndjek të njëjtën metodologji dhe kronologji, pasi administrohen më parë aktet e paraqitura nga palët e më pas ato të krijuara nga gjykata, duke e bërë të lehtë shfrytëzimin e dosjeve për palët. Në shumicën e rasteve, aktet në dosje janë të inventarizuara shumë shkurt...”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*padia, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e dokumentimit të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare*).

Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara (*me përjashtim të 2 çështjeve penale në të cilat mungon vendimi i caktimit të seancës gjyqësore*), apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi pavarësisht se në dy raste mungojnë vendimet e caktimit të seancës gjyqësore, kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e çështjes dhe përfundimin e saj, pasi gjykata ka marrë masat për njoftimin e palëve për seancën e parë gjyqësore dhe asnjë veprim apo mosveprim nga ana e saj nuk ka ndikuar në zvarritjen apo moszhvillimin e seancave gjyqësore efektive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shumë mirë	89

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Lidhur me këtë nën-kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkluzionet se: “...Gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtaren {...} janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së 2 ankesa, 1 ankesë e vitit 2015, e verifikuar për vonesë në zbardhjen e vendimit, është sugjeruar tërheqje e vëmendjes me shkrim gjyqtarës, ndërsa ankesa tjetër e vitit 2016, e verifikuar për 2 ditë vonesë në zbardhjen e vendimit, i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së). Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së).”.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD rezulton se, shkakun e referimit për t'u mbajtur në konsideratë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve ka qenë dorëzimi me vonë i vendimit gjyqësor.

Nuk konstatohet në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD, të jenë evidentuar elemente që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarëve.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 165, datë 21.06.2019, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elemente që mund të ndikojnë në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarëve, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.³¹

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarëve në treguesin "angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion" është "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARËS

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkluzionet se: "...Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm...".

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

³¹ Shih faqen 32 dhe 33 të vendimit të KPK, administruar në dosje.

- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton të jetë paraqitur dy ankesa, referuar në treguesin më sipër, një ankesë e verifikuar për vonesë në zbardhjen e vendimit, është sugjeruar tërheqje e vëmendjes me shkrim gjyqtares, ndërsa ankesa tjetër e verifikuar për vonesë në zbardhjen e vendimit, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë..”*³²

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 165, datë 21.06.2019, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtares, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, duke konkluduar se: *“Më tej, Komisioni konstaton se nuk ka asnjë informacion apo indicie që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë veprë penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës, dhe në ligjin nr. 84/2016. 6. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”*³³

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojnë shfaqje të pahijshme, apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

³² Shih faqen 30 të vendimit të KPK, administruar në dosje.

³³ Shih faqen 30 të vendimit të KPK, administruar në dosje.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integriteti, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, në asnjë rast nuk është konstatuar të ketë patur objekt çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme”.³⁴

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues rezulton se në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja, aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, si dhe dosjen e administruar për shkak të ankesave, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse, gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu,

³⁴ Në faqen 34 të tij

nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: “..Për vetë gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit nuk ka të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, duhet të jetë i paanshëm dhe duhet të shfaqë paanësi në ushtrimin e detyrës, në

mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me aftësitë e komunikimit, konstatohet se: *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në të gjitha rastet, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se: Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimeve shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*), rezulton se komunikimi i gjyqtares me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i drejtpërdrejtë, i qartë, transparent, i kuptueshëm, duke respektuar të drejtat e palëve në proces dhe duke treguar kujdes për të treguar trajtim të barabartë dhe me dinjitet të tyre. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të orientuar debatin gjyqësor apo qartësuar kërkimet e palëve, komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe korrekt, në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Në komunikimin shkresor me subjektet palë ose jo në procesin gjyqësor, gjuha e përdorur është korrekte, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 dosje e administruar për shkak të ankesave*);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar, konstatohet se “Në dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Janë evidentuar vetëm dy raste që ka patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, por jo vonesa në arsyetimin e vendimeve, që të lidhet me nivelin e bashkëpunimit të tij me administratën gjyqësore dhe kolegët”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe

mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit, vërtetimit me nr. 587 Prot., datë 20.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarës së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses.

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 587 Prot., datë 20.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

- Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhues në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë trajnimi;

Rezulton gjithashtu se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnim jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, i cili rezulton të jetë aktivitet i formimit profesional, si dhe aktivitetet ndërinstitucional. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës - trajnimi online i organizuar nga Këshilli i Europës, organizata HELP, me temë “Sanksionet komunitare dhe alternativat e dënimit me burgim”, certifikuar në datën 31.12.2013.

KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile, penale etj., gjithsej 13 aktivitete të zhvilluara për 19 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të mësipërme të vlerësimit, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lektore dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja, ka paraqitur kundërshtime duke parashtruar se dokumenti i lëshuar nga HELP dhe Këshilli i Europës, lidhet me një organizim të ndërmarrë nga ana e Këshillit të Europës, në të cilën kanë qenë pjesëmarrës profesionistë me njohuri në fushën e ligjit ku nëpërmjet lidhjes online janë shkëmbyer mendime dhe eksperiencia në lidhje me alternativat e dënimit me burgim, nuk mund të vlerësohet si një trajnim i kryer jashtë shkollës së magistraturës, por si një zgjidhje e një çështje me rëndësi sikundër është mbipopullimi i burgjeve, përmes aplikimit të formave alternative të dënimit.

Duke iu referuar vetë përmbajtjes së certifikatës, ku shkruhet në gjuhën angleze: *“Certifikatë - akorduar në kuadrin e Programit European për Arsimimin e Profesionistëve të së Drejtës (Human Rights Education for Legal Professionals HELP), për kursin e të mësuarit në distancë për masat në komunitet dhe alternativat e dënimit me burgim - {...} – e cila ka përmbushur plotësisht kërkesat e të mësuarit në kursin e sipërpërmendur në 31 dhjetor 2013”*, duket qartë që bëhet fjalë për një kurs trajnimi, e jo për një kontribut të gjyqtares për zgjidhjen e një çështjeje me rëndësi sikundër është mbipopullimi i burgjeve, përmes aplikimit të formave alternative të dënimit. Përveç

kësaj, ky konkluzion bazohet edhe në dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga vetë gjyqtarja, emailin e dërguar në adresën e saj, ku ndër të tjera, përmendet shprehimisht: “...Këtë javë në këtë kurs do të merrni informacion për pjesëmarrjen e komunitetit dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm të tij, si premisë bazë për zbatimin e suksesshëm të të masave dhe sanksioneve komunitare. Detyra vetëvlerësuese në këtë modul është vetëm me alternativa shumëfishe”. Pra, rezulton që në këtë aktivitet gjyqtarja ka marrë pjesë për të mësuar në një trajnim formimi profesional të organizuar nga Këshilli i Europës, në përfundim të të cilit ka kaluar me sukses testimin me alternativa shumëfishe.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi, apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të vetëvlerësimit profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikimet ligjore akademike” gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	89	Shumë mirë
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	380	Shumë mirë

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	Mbi 87-93%
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar; 	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Mbi mesataren
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas 	Shumë e lartë

dosjen gjyqësore		fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarës	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarës	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë

	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	15-120 ditë
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	Nuk ka të dhëna
	c. Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivleresimit; 	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			380
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Shumë